



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR SHKUMBIN

VENDIM
Nr.1, datë 21.11.2022

PËR
**MIRATIMIN E LEJES “PËR KRYERJE SHPIMI NËNTOKËSOR
PËR NXJERRJE UJI (PUS-SHPIMI)”**
SUBJEKTIT “ANMETAL” SH.P.K

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Shkumbin,

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes për kryerje shpimi nëntokësor për nxjerrje uji (pus-shpimi), subjektit “Anmetal”sh.p.k, me vendndodhje Njësia Administrative Bradashesh Elbasan Qarku Elbasan.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:
Vendndodhja e përcaktuar për pus-shpimin sipas KRGJSH
- $X= 501456.9$; $Y= 4550264.29$; $Z= 96$ m.m.n.d
- Prurja e kërkuar: $Q= 0.8$ l/sek
3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

KRYETARI I KBU SHKUMBIN

MAJLINDA PERRIU

